REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE, SHËNDETËSORE DHE STREHIMIT
SEKTORI I KUJDESIT SOCIAL DHE PAK

Nr. Prot. **Bilisht më, . . 2025**

PROJEKT-VENDIM

NR. 01, DATË 21 / 01 /2025

"PËR PËRCAKTIMIN E VLERËS MESATARE TË TREGUT PËR SUBVENCIONIMIN E QIRASË" QË PËRFITOJNË FAMILJET E PASTREHA QË BANOJNË MË QIRA NË TREGUN E LIRË DHE NUK KANË TË ARDHURA TË MJAFTUESHME PËR TË PËRBALLUAR VETË GJITHË VLERËN E QIRASË PER VITIN 2025"

Në mbështetje të nenit 113 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, neni 8 pika 2, neni 9 pika 1/1 shkronja "b", neni 24 dhe neni 54 shkronja "k" dhe nenit 55 pika 2 e 6 të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë" neni 33 dhe 34 të Ligjit Nr. 22/2018 "Për Strehimin Social" i ndryshuar, VKM Nr.362 datë 29.05.2019, "Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionin e qirasë në tregun e lirë nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij",VKM Nr. 384 datë 12.06.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore", VKM Nr. 301 datë 15.04.2020 "Për normat e strehimit, si dhe kushtet e standartet për banesat sociale me qira që blihen në treg dhe banesat me kosto të ulët".

PROPOZOJ:

1. Miratimin e vlerës mesatare të tregut të lirë për subvencionimin e qirasë, sipas VKM nr. 301 datë 15.04.2020 "Për normat e strehimit, si dhe kushtet e standartet për banesat sociale me qira që blihen në treg dhe banesat me kosto të ulët", për të gjitha Njësitë Administrative të Bashkisë Devoll, si më poshtë;

Sipërfaqet për çdo lloj banese				
Nr.	Tipi i njësisë së banimit	Sipërfaqe Neto (m2)		
		Minimale	Maksimale	Vlera e qirasë
1	Studio	30	45	4000
2	1+1	40	55	5000
3	2+1	50	81	7000
4	3+1	60	100	9000

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Kujdesit Social dhe PAK dhe Drejtoria e Menaxhimit Financiar.

3.Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55 të ligjit 139/2015 për "Vetëqeverisjen vendore" I ndryshuar

Konceptoi: Specialiste për administrimin e nevojave për strehim
Linda Laçi

Konfirmoi: Përgjegjës i sektorit të Kujdesit Social
Marilda Bejleri

Miratoi: Drejtor i Shërbimeve Sociale, Shëndetësore dhe Strehimit
Zerina Sinani

Konfirmoi bazen ligjore:
Përgjegjëse e Sektorit Juridik
Eriksela Avdo

KRYETARI I BASHKISË
Eduard Duro

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA DEVOLL

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE, SHËNDETËSORE DHE STREHIMIT
SEKTORI I KUJDESIT SOCIAL DHE PAK

Nr. 26 **Prot.** **Bilisht më,** 21.01.**2025**

RELACION

PËR MIRATIMIN E VLERES MESATARE TE TREGUT PER BANESAT SOCIALE ME QIRA

Në mbështetje të nenit 113 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, të ligjit Nr.22/2018 "Për Strehimi Social" i ndryshuar, **VKM nr. 301 datë 15.04.2020 "Për normat e strehimit, si dhe kushtet e standartet për banesat sociale me qira që blihen në treg dhe banesat me kosto të ulët".** VKM nr.1093 datë 28.12.2015, "Për miratimin e procedurave, kritereve dhe përparësive për dhënien e bonusit të strehimit" i ndryshuar i cili përcakton qartë proçedurat dhe kriteret për dhënien e bonusit të qirasë për familjet e pastreha si dhe VKM Nr. 89, datë 03.02.2016 "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë".

Përparësi në subvencionimin e qirasë, sipas sistemit të pikëzimit, kanë por pa u kufizuar në to, kategoritë e përcaktuara në nenet 33 dhe 34/3 të ligjit nr. 22/ 2018 "Për Strehimin Social" përfshirë individët, që dalin nga sistemi i përkujdesjes alternative si individët me statusin e jetimit, personat me aftësi të kufizuar, të moshuarit, invalidët e punës, familjet e policëvë të rënë në detyrë, emigrantët e rikthyer, punëtori emigrant, azilkërkuesi, familjet e komunitetit rom, familjet e komunitetit egjiptian, viktimat e dhunës në familje, viktimat e trafikimit/viktimat e mundshme të trafikimit, prindërite vetëm që kanë në ngarkim fëmijë, individët që i përkasin komunitetit LGBTI, të miturit 14 – 18 vjeç dhe të rinjtë 18-21 vjeç në konflikt me ligjin, vajzat nëna, pas daljes nga programi i banesave sociale të specializuar, familjet me statusin e e qiramarësit, në banesave ish-pronë private, sipas Aktit Normativ me Fuqinë e Ligjit nr.3, datë 01.03.2012. Në bazë të Vendimit nr.362 datë 29.05.2019 "Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë të tregut të lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij pika 4, njësia e vetëqeverisjes vendore përcakton vlerën konkrete të subvencionit të qirasë për banesat në pronësi të pronarit social në tregun e lirë bazuar në:
a) vlerën mesatare në tregun e lirë, e cila vlerësohet sipas zonave të ndryshme urbane e rurale të një njësie të vetëqeverisjes vendore

b) të ardhurat familjare, sipas kategorizimit të pikës 44, të nenit 2, të ligjit nr. 22/2018

c) aftësinë e familjes për të përballuar pagesat mujore të qirasë, sipas përcaktimeve të nenit 3, të ligjit nr. 22/2018.

Përgjegjës i Sektorit të Kujdesit Social

Marilda Bejleri

Adresa: Lagja Nr. 1, Rr. 24 Tetori Nr. 9; Tel+355811122288; E-mail: bashkiadevoll@gmail.com; web: